L I G J
Nr.8755, datë 26.3.2001

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETIT EUROPIAN PËR PROGRAMET E NDIHMËS HUMANITARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K UV E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian për programet e ndihmës humanitare".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2959, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETIT EUROPIAN MBI PROGRAMET E NDIHMËS HUMANITARE

Komisioni i Bashkimit Europian, që më poshtë do të quhet si "Komisioni", duke vepruar nga një anë, dhe

Qeveria e Shqipërisë, duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë, të quajtur më poshtë si Shqipëria

Nga ana tjetër,

Dhe së bashku, të quajtura "Palët kontraktuese"

Duke marrë parasysh që Shqipëria po përfiton nga programi i ndihmës humanitare të Komunitetit si përshkruhet në Rregulloren e Këshillit Europian EC Nr.1257/96 të 20 Qershorit 1996,

Ka rënë në Marrëveshje si më poshtë:

Neni 1

Me qëllim që të realizojë bashkëpunimin midis palëve kontraktuese, me qëllim që të zbatojë veprime të ndihmës humanitare siç është cilësuar në Rregulloren e Këshillit të Komunitetit Europian nr.1257/96 të 20 Qershorit 1996, dhe e cila do financohet dhe zbatohet brenda kuadrit teknik, ligjor dhe administrativ të përcaktuar në kontratën e Partneritetit midis Komisionit Europian përmes ECHO-s (Zyra Humanitare e Komunitetit Europian) dhe partnerëve zbatues, Palët Kontraktuese bien dakord për artikujt e mëposhtëm të parashtruar në këtë Marrëveshje.

Detajet specifike të çdo veprimtarie janë vendosur në një kontratë veprimtarie midis partnerëve zbatues dhe Komisionit.

Shqipëria merr të gjithë hapat e nevojshëm që të sigurojë një zbatim të përpiktë të të gjitha veprimtarive.

Neni 2

Çdo veprimtari që është financuar brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet në përputhje me kushtet e vendosura në Ankesin 1.

Neni 3

Për çështje që lidhen me veprimtari të financuara brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të përfaqësohet në Shqipëri nga Delegacioni i tij në Tiranë, i cili do të sigurojë, në emër të Komisionit, që veprimtaritë janë ekzekutuar në përputhje me praktika të shëndosha financiare dhe teknike.

Neni 4

Kjo Marrëveshje është bërë në gjuhën angleze në dy kopje origjinale.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën që Palët Kontraktuese informojnë njëri-tjetrin për miratimin e saj në përputhje me procedurat e tyre të brendshme.

Marrëveshja do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej 5 vjetësh, në qoftë se nuk përfundohet sipas një deklarate me shkrim nga njëra ose tjetra palë kontraktuese. Marrëveshja do të përfundojë së zbatuari tre muaj pas kësaj deklarate.

Me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje çdo veprimtari që është akoma në zbatim do të përfundohet në përputhje me termat e Marrëveshjes aktuale.

Anekset do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë më 13.12.2000

Për Qeverinë e Republikës së ShqipërisëPër Komisionin Europian
Ermelinda Meksi Mishel Peretti

ANEKSI 1
FONDI I LEHTËSIVE

Neni 1
Përfitimet e përgjithshme

Personeli që bën pjesë në veprimtaritë humanitare të financuara nga Komuniteti dhe anëtarët e familjeve të tyre mund të marrin po ato përfitime, privilegje dhe përjashtime të bëra për të huajt e tjerë të punësuar nën ndonjë Marrëveshje bilaterale ose multilaterale për ndihmë ekonomike dhe program bashkëpunimi teknik.

Neni 2
Vendosja, akomodimi, hyrja dhe lehtësitë e qëndrimit

Shqipëria do të lejojë personelin që zbaton veprimtaritë e financuara nga Komuniteti dhe pjesëtarët e familjeve të tyre do hyjnë në Shtetin Shqiptar, të vendosin veten e tyre në Shtet, të punojnë aty dhe të lënë Shtetin, ashtu siç e justifikon natyra e veprimtarisë së tyre.

Neni 3
Importi dhe rieksporti i pajisjeve

Shqipëria do të japë lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të nevojshme

për të realizuar veprimtarinë, në bazë të ligjeve ekzistuese dhe rregulloreve të Shqipërisë.

Shqipëria do t'u japë personave fizikë dhe juridikë që e kanë kryer veprimtarinë, mundësinë të rieksportojë pajisjet e përmendura.

Neni 4

Taksat dhe Doganat

1. Importimet nga partnerët zbatues të mallrave të nevojshme në kuadrin e veprimtarive të financuara nën fondin e KE-së përmes ECHO-s do të përjashtohen nga çdo detyrim importi dhe taksa me efekt të njëjtë.

2. Shqipëria do të sigurojë që importimet do të bëhen nga pika e hyrjes për shpërndarje te partneri zbatues dhe për përdorim të menjëhershëm siç është kërkuar për zbatimin normal të veprimtarisë, pa asnjë vonesë ose keqkuptim, përsa i përket vendosjes së detyrimeve, taksave dhe tatimeve të sipërpërmendura.

Aty ku një kontratë furnizimesh e financuar nga fondet e KE-së përfshin një produkt që vjen nga Shqipëria, kontrata do të përfundohet në bazë të çmimeve të ish-punimeve të pajisjeve në fjalë, të cilave do t'iu shtohen tatimet e brendshme fiskale të zbatuara në Shqipëri për këto pajisje.

3. Sendet personale dhe shtëpiake të importuara për përdorim personal nga personat fizikë (dhe pjesëtarë të familjeve të tyre), përveç atyre të marra lokalisht, të ngarkuar që të realizojnë veprimtarinë do të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit ose tatime të tjera fiskale me të njëjtin efekt, sendet personale dhe shtëpiake të përmendura do të rieksportohen ose nxirren jashtë përdorimit në përputhje me rregulloren në fuqi në Shqipëri pas përfundimit të veprimtarisë.

4. Personat fizikë dhe juridikë që importojnë pajisje profesionale, siç është parashikuar në Artikullin 3, do të përfitojnë, në qoftë se kërkohet, nga sistemi i pranimit të përkohshëm, siç është përcaktuar nga legjislacioni kombëtar i Shqipërisë për pajisjet e përmendura.